

# STATUTI

JAA SHPK

08 Gusht 2018

## PËRMBAJTJA

<b>KREU I</b>	<b>EMRI, THEMELIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA</b>	<b>Faqe</b>	<b>2</b>
NENI 1	Emri i shoqërisë	Faqe	2
NENI 2	Data e themelimit	Faqe	2
NENI 3	Selia e shoqërisë	Faqe	2
NENI 4	Themeluesi	Faqe	2
NENI 5	Objekti i veprimtarisë	Faqe	2
NENI 6	Kohëzgjatja	Faqe	3
<b>KREU II</b>	<b>KAPITALI, KONTRIBUTET E KAPITAL THEMELTAR, SHPËRNDARJA E KUOTAVE ETJ.</b>	<b>Faqe</b>	<b>3</b>
NENI 7	Kapitali themeltar	Faqe	3
NENI 8	Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit	Faqe	3
NENI 9	Transferimi i kapitalit	Faqe	3
<b>KREU III</b>	<b>ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE</b>	<b>Faqe</b>	<b>4</b>
NENI 10	Organi Vendimmarrës	Faqe	4
NENI 11	Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme	Faqe	4
NENI 12	Kuorumi	Faqe	5
NENI 13	Martja e vendimeve	Faqe	5
NENI 14	Përgjegjësi nga e drejta e votës	Faqe	5
NENI 15	Administrimi	Faqe	5
NENI 16	Kompetencat e administratorëve	Faqe	6
NENI 17	Përgjegjësitë e administratorit	Faqe	6
<b>KREU IV</b>	<b>VITI FINANCIAR, EKSPERTET KONTABEL, FITIMET</b>	<b>Faqe</b>	<b>7</b>
NENI 18	Viti Financiar	Faqe	7
NENI 19	Ekspertët Kontabël	Faqe	7
NENI 20	Fitimet	Faqe	7
<b>KREU V</b>	<b>PRISHJA DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË</b>	<b>Faqe</b>	<b>7</b>
NENI 21	Prishja dhe Likuidimi	Faqe	7
NENI 22	Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja	Faqe	8
NENI 23	Baza Ligjore	Faqe	8
NENI 24	Mosmarrëveshjet	Faqe	8

**KREU I**  
**EMRI, THEMELIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

**NENI 1**  
**EMRI I SHOQËRISË**

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “JAA”

**NENI 2**  
**DATA E THEMELIMIT**

Shoqëria “JAA” është themeluar në datën 08.08.2018 (08 Gusht 2018).

**NENI 3**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Selia e shoqërisë është me adresë Rruga Alla Nd. 10, H. 1, Ap. 1, Selitë, Farkë, 1044 Tiranë, Shqipëri.

**NENI 4**  
**THEMELUESI**

Themeluesi i shoqërisë është Z. Dritan Metaj, shtetas shqiptar, i biri i Xhevitit dhe i Rutnies, i datëlindjes 29.01.1982, lindur në Tiranë, dhe banues në adresën Rruga Alla, Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit me numër Letërnjoftim 024740120 dhe me numër personal I20129105U, i lëshuar nga MB në datën 30.03.2009.

**NENI 5**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

1. Veprimtaria e shoqërisë do të jetë;
  - 1.1. Krijimi i akademisë së futbollit, ndërtimin dhe shfrytëzimin e akademisë sportive si institucion formimit sportiv për të gjithë moshat.
  - 1.2. Regjistrimin e akademisë pranë federatës së futbollit dhe institucioneve përkatëse.
  - 1.3. Realizimin dhe shfrytëzimin e terreneve sportive për përgatitjen fizike dhe teorike të sportistëve.
  - 1.4. Krijimi i skuadrave sportive të moshave dhe disiplinave sportive të ndryshme.
  - 1.5. Krijimin e grupeve stërvitore dhe skuadrave të futbollit amatore dhe profesionale, grupeve stërvitore dhe skuadres së futbollit të rinjve, grupeve stërvitore dhe skuadres së futbollit të rriturve.
  - 1.6. Organizimin e veprimtarive të ndryshme sportive, konkretisht të aktivitetit të futbollit në Shqipëri dhe jashtë saj.
  - 1.7. Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit si dhe gara të tjera sportive kombetare dhe ndërkombëtare.
  - 1.8. Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtar dhe ndërkombëtar.
  - 1.9. Futja në tregun e lojtareve për të blerë dhe shitur lojtare sipas nevojave të ekipit.
  - 1.10. Aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë.
  - 1.11. Agjenci udhëtimi, agjenci imobiliare, Veprimtari në fushën e shërbimeve si agjenci udhëtarësh dhe prerje biletash për linjat kombetare dhe ndërkombëtare, agjenci detare, udhëtimesh, transport pasagjërësh dhe mallrash për transport detar, ajror e tokësor, agjenci spëdicionerësh dhe shërbimesh portuale në përgjithësi, organizim dhe menaxhim i grupeve turistike shqiptare dhe të huaja për vizita turistike brenda dhe jashtë vendit, organizime dhe menaxhime aktivitetesh seminarësh, konferencash, ditëlindjesh, përvjetorësh, përzemimesh dhe ngjarjesh të tjera të rëndësishme në të gjithë komponentet përberëse.
  - 1.12. Realizimi i projekteve për marketing dhe komunikim publicitar si dhe zbatimin e tyre në emër të organeve publike, shoqëritë private dhe për vetë, për prezantimin dhe promovimin e shitjes të produkteve dhe shërbimeve;
  - 1.13. Veprimtaritë e lidhura dhe të ngjashme me ato të renditura më sipër, të blej, të shes, të marrë hua, të japë me qira të mira të tundshme e të patundshme dhe çdo gjë tjetër të nevojshme e të vlefshme për realizimin e drejtpërdrejtë o të tërthortë të qëllimit të shoqërisë.
  - 1.14. Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mesiperme, shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmes, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Për përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria mund;
    - 1.14.1. Të zotërojë direkt ose indirekt pjesëmarrje në shoqëri dhe/ose sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njejta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose që mund të ndihmojnë në realizimin e objektit të Shoqërisë;

- 1.14.2. Te themeloje dege, zyra perfaqesimi dhe ne pergjithesi te kryeje cdo aktivitet tjeter qe nuk eshte i ndaluar nga ligji.
- 1.15. Import dhe export te produkteve sportive dhe stervitore, tregtimin e te gjitha produkteve te deshuruara qoftë drejtpërdrejt ose përmes palëve të treta, kryesisht mallra e produkte të nevojshme për kryerjen aktivitetit ekonomik e përmbushjen e objektivave tregtare.
- 1.16. Shoqëria mund të marrë pjesë në tenderime shtetërore dhe private, vetëm ose me palë të treta.
- 1.17. Si pjesë e aktivitetit të saj shoqëria mund të financoj palë të treta , ose mund të marrë financime dhe të kryej ndërmjetime dhe brokerime të çdo lloji, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- 1.18. Bashkpunimi me kompani e subjekte të të njëjtës fushë si dhe ndërmjetime konsulenca për vendosjen e shoqërive të huaja në Shqipëri.
- 1.19. Kontraktimi i personave fizikë ose juridik brënda dhe jashtë vëndit me shtetësi Shqiptare ose të huaj per gjetjen e tregjeve të reja për shitjen dhe blerjen e produkteve ose të shërbimeve që ofron shoqëria jonë.
- 1.20. Do të kryhet çdo veprimtari e lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi me qëllim përmbushjen e objektit tregëtar të shoqërisë.

## **NENI 6 KOHËZGJATJA**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë;
  - 1.1. Kohëzgjatja e shoqërisë JAA SH.P.K. vendoset për një periudhë të pacaktuar kohore nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

## **KREU II KAPITALI, KONTRIBUTET E KAPITAL THEMELTAR, SHPËRNDARJA E KUOTAVE ETJ.**

### **NENI 7 KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme. Kontributi i kapitalit themeltar ka ndodhur si vijon:
  - 1.1. Ortaku Themelues: Z. DRITAN METAJ zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 Leke (Njëqind mijë) që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - 1.2. Ortaku i vetëm ka depozituar kapitalin themeltar prej 100,000 (njëqind mijë) lekë në një llogari bankare.

### **NENI 8 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e ortakëve e një eksperti kontabël të regjistruar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **NENI 9 TRANSFERIMI I KAPITALIT**

1. Kuotat mund t'iu transferohen palëve të treta tërësisht ose pjesërisht nëpërmjet;
  - 1.1. Kontributit në kapitalin themeltar.
  - 1.2. Blerjes dhe shitjes së kuotave.
  - 1.3. Trashgimisë.
  - 1.4. Dhurimit.
  - 1.5. Çfarëdo mjeti tjetër të parashikuar nga ligji.
  - 1.6. Në rastin e transferimit të ndonjë titulli të kuotave ndaj palëve të treta, ortakët e tjerë mund të preferohen në blerjen e kuotave në proporcion me kuotat e tyre në të njëjtin çmim dhe nën kushte të njëjta të ofruara nga pala e tretë.
  - 1.7. Në këtë rast ortakët duhet t'iu komunikojë ortakëve të tjerë çmimin e ofruar nga pala e tretë, duke siguruar prova me shkrim të ofertës, dhe ortakët e tjerë do të kenë 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës për të informuar

- ortakun shitës dhe ortakët e tjerë për vullnetin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Kur ortakët e tjerë nuk përgjigjen brënda afatit kohor, do të thotë se kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes në favor të tyre.
- 1.8. Nëse një prej ortakëve të tjerë, që ofrohet për të blerë në parablerje për pjesen e tij kuotat e ortakut të shitjes, nuk synon të ushtrojë të drejtën e parablerjes, ortakët e tjerë të cilët kanë ushtruar tashmë për pjesën e tyre të drejtën e tyre të parablerjes mund të zgjerojnë këtë të drejtë për të gjitha ose një pjesë të kuotave të ofruara në parablerje për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes.
  - 1.9. Në rast se më shumë ortakë dëshirojnë të zgjerojnë të drejtën e parablerjes, të ofruara për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes në mosmarrëveshje do të ndahet në pjesë të barabarta.
  - 1.10. Në rastin kur vetëm njëri ortak dëshiron të zgjerojë të drejtën e tij të parablerjes, parablerjes në mosmarrëveshje ofruar për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, do të transferohet plotësisht në të gjitha ose pjesën që ai synon për të blerë.
  - 1.11. Në këtë aspekt, anëtarët dëshirojnë të zgjerojnë të drejtën e tyre të parablerjes duhet të njoftojë ortakun shitës, vendimin e tij brënda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e njoftimit të mungesës për të ushtruar të drejtën e parablerjes.
  - 1.12. Të gjitha këto komunikime duhet të jenë me shkrim.

### **KREU III ORGANET VENDIMARRËSË DHE DREJTUESE**

#### **NENI 10 ORGANI VENDIMARRËS**

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
3. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - 3.1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
  - 3.2. Ndryshimet e statutit.
  - 3.3. Emërimin e shkarkimin e administratorëve.
  - 3.4. Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar.
  - 3.5. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në nën pikat “3.3” dhe “3.4” të pikës 3, Neni 10.
  - 3.6. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë.
  - 3.7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
  - 3.8. Shpërndarjen e fitimeve vjetore.
  - 3.9. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
  - 3.10. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
  - 3.11. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
  - 3.12. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
  - 3.13. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
  - 3.14. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
7. Vendimet e shumicës të Asamblese janë detyruese për ortakë që mungojnë ose janë kundër, por kane të drejtën e ankimit në rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.

#### **NENI 11 MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

1. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me leter rekomande që duhet t`u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve ose nëpërmjet postës elektronike.
2. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t`u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtate) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të nenit 11, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **NENI 12 KUORUMI**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **NENI 13 MARRJA E VENDIMEVE**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
  - 2.1. Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë.
  - 2.2. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve.
  - 2.3. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
  - 2.4. Përcaktimin e shpërblimeve.
  - 2.5. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë.
  - 2.6. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
  - 2.7. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
  - 2.8. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **NENI 14 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim;
  - 1.1. Vlerësimin e veprimtarisë së tij.
  - 1.2. Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
  - 1.3. Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria.
  - 1.4. Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## **NENI 15 ADMINISTRIMI**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.
4. Administratori i emëruar për shoqërinë është;
  - 4.1. Z. DRITAN METAJ, shtetas shqiptar, i biri i Xhevitit dhe i Rutnies, i datëlindjes 29.01.1982, lindur në Tiranë, dhe banues në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Robert Shvarc, Tiranë, mbajtes i dokumentit të identitetit tip kartë identiteti me nr. Letërnjoftim 024740120 dhe me nr. personal I20129105U, i leshuar nga MB në datën 30.03.2009.

## NENI 16 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - 1.1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
  - 1.2. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare.
  - 1.3. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
  - 1.4. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
  - 1.5. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
  - 1.6. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për qendrën kombëtare të regjistrimit.
  - 1.7. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
  - 1.8. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:
  - 2.1. Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - 2.2. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - 2.3. Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padië, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## NENI 17 PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:
  - 3.1. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - 3.2. Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - 3.3. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - 3.4. Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - 3.5. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:
  - 6.1. U kthen ortakëve kontributet.
  - 6.2. U paguan ortakëve interesa apo dividendë.
  - 6.3. U shpërndan aktivet shoqërisë.
  - 6.4. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.
  - 6.5. Jep kredi.

7. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
8. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTET KONTABEL, FITIMET**

### **NENI 18 VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **NENI 19 EKSPERTËT KONTABEL**

1. Nëse është e nevojshme apo të kërkohet nga ligji, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave te shoqërisë do t'i besohet një audituesi të autorizuar të emëruar në mënyrën e përcaktuar me ligj me te drejte riemërimi.
2. Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakëve.
3. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i regjistruar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakëve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.
4. Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se njejte te emerimit.

### **NENI 20 FITIMET**

1. Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, zbritur 5% (pese perqind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) të kapitalit themeltar, dhe gjithashtu të gjitha shumat e tjera që Asambleja vendos t'i vërë mënjanë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara respektivisht.
2. Asambleja mund te vendose edhe zbritje te veçanta në favor të rezervave te jashtezakonshme ose për qëllime të tjera apo edhe shtyrjen e shpërndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

## **KREU V PRISHJA DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **NENI 21 PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë;
  - 1.1. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj.
  - 1.2. Me vendim të asamblesë së ortakëve.
  - 1.3. Me hapjen e procedurave të falimentimit.
  - 1.4. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”.
  - 1.5. Me vendim të gjykatës.
2. Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatore dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e siper”.
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.
5. Nëse Ortakët nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**NENI 22**  
**RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 23**  
**BAZA LIGJORE**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 24**  
**MOSMARRËVESHJET**

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky statut u lexua dhe u nënshkrua në datën 08 Gusht 2018.

ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
**JAA SH.P.K.**

**DRITAN METAJ**

*Dritan Metaj*  
\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër, nënshkrimi)

